



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 175

Tiranë – E mërkurë, 7 tetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 3.10.2015	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015 – 2016..... 11991
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 10.3. 2015	Çështja “Siliqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë” (ankimet nr. 37295/05 dhe 42228/05)..... 11993
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 16.7. 2015	Çështja “Metalla dhe të Tjerë kundër Shqipërisë” (kërkesat nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08) 11996
Udhëzim i ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 4381/1, datë 22.9.2015	Për transformimin e koordinatave nga korniza referuese gjeodezike globale “TTRF 2005 (Epoka 2007.2)” dhe sistemi gjeodezik shqiptar “ALB 86” në kornizën referuese gjeodezike evropiane “ETRF 2000 (Epoka 2014.177)” dhe “ETRF 2000 (Epoka 2008)”..... 12003

**VENDIM****Nr. 808, datë 3.10.2015**

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE
TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE
AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË TË
STUDIMEVE, NË FUSHËN E
MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK
2015 – 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, pika 4, 35 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016, janë 97, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----|
| a) Kuota për kandidatët brenda territorit të vendit | 92; |
| b) Kuota për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet jashtë kufijve të vendit | 5. |

2. Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----|
| a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë | 80; |
| b) Kuota për transferime, të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë | 3; |
| c) Kuota pranimi të pambuluara nga Ministria e Drejtësisë | 2; |
| ç) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes | 5; |
| d) Kuota pranimi të pambuluara nga Ministria e Punëve të Brendshme | 2. |

3. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, të përcaktuara në

shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje, sipas programeve të studimit, të pasqyruara në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi. Këto kuota rishpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë.

5. Kandidatët nga republikat e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi dhe nga prefekturat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes, aplikojnë direkt në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe u nënshtrohen të njëjtave procedura konkurrimi si edhe kandidatët shqiptarë brenda territorit të vendit. Pranimi i tyre në programin përkatës të studimit bëhet bazuar në kriterin e meritës, duke respektuar kuotat për këtë kategori kandidatësh.

6. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur në kërkesat e Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializuese afatgjata, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.

7. Aplikojnë, për programe studimi specializuese, afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.

8. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit, rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

9. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata, në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është 115 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë, në llogarinë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, 30% të tarifës vjetore të shkollimit. Këstet e tjera arkëtohen sipas



rregullores së miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

10. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

11. Fakulteti, që mbulon programin specializues afatgjatë, siguron studentët për përgjegjësinë profesionale ndaj palëve të treta dhe për shëndetin e tyre, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, përpara fillimit të programit specializues dhe në vijim, në çdo fillim viti akademik, duke nisur nga data e skadencës së policës së lidhur një vit më parë.

12. Studentët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij vendimi, lidhin kontrata, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku përcaktohen detyrimet mes palëve si dhe penalitetet, në rastet e mosrespektimit të tyre. Modeli i kontratës dhe

modalitetet e lidhjes së saj përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe i bëhen të ditura kandidatit para hapjes së procesit të aplikimeve.

13. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, një shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse.

14. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pa efekte buxhetore shtesë.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA NR. 1

KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Brendshme	Kuota për kandidatë nga Trojet	Gjithsej
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	1	Alergjologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	2	Anatomi Patologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3	Anestezia reanimacion	4	1	-	-	1	6
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	4	Dermatologji	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	5	Endokrinologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	6	Gastrohepatologji	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	7	Hematologji	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	8	Diagnozë me imazhe	3	-	1	1	1	6
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	9	Kardiokirurgji	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	10	Kardiologji	5	1	1	1	-	8
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	11	Kirurgji e përgjithshme	4	-	-	-	-	4
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	12	Kirurgji maxillo-faciale	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	13	Laborator klinik-biokimik	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	14	Mikrobiologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	15	Mjek familje	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	16	Mjekësi interne	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	17	Mjekësi ligjore	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	18	Nefrologji	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	19	Neurologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	20	Neurokirurgji	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	21	ORL	3	-	-	-	1	4
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	22	Obstetrikë ginekologji	4	-	-	-	1	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	23	Okulistikë	3	2	-	-	1	6
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	24	Onkologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	25	Ortopedi traumatologji	-	1	-	-	-	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	26	Pediatri	5	-	-	-	-	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	27	Pneumologji	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	28	Psikiatri	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	29	Psikiatri e fëmijëve	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	30	Rheumatologji	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	31	Sëmundje infektive	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	32	Shëndet publik	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	33	Pedodonti	-	-	-	-	-	0
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	34	Toksikologji klinike	3	-	-	-	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	35	Mjekësi urgjence	4	-	-	-	-	4
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	36	Mjekësi transfuzive	2	-	-	-	-	2
		TOTALI	80	5	2	2	5	94



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Seksioni i katërt

ÇËSHITJA “SILIQI DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË”

(Ankimet nr. 37295/05 dhe 42228/05)

VENDIM STRASBURG

10 mars 2015

Ky vendim është i formës së prerë, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen “Siliqi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë”,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si një komitet i përbërë nga:

George Nicolaou, President,

Ledi Bianku,

Krzysztof Wojtyczek, gjyqtarë,

dhe Fatoş Aracı, zëvendëssekretar i seksionit,

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 17 shkurt 2015,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e sipërpërmendur:

PROCEDURA

1. Çështja nisi me dy ankesa (nr. 37295 dhe 42228/05) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë, nga katër shtetas shqiptarë, në përputhje me nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Ankesa nr. 37295/05 u paraqit nga znj. Drita Siliqi, me mbiemër vajzërie Shundi, znj. Mariana Shundi dhe z. Andrea Shundi, më 3 tetor 2005, ndërsa ankesa nr. 42228/05 u paraqit nga znj. Gjenovefa Mihali, me mbiemër vajzërie Shundi, dhe znj. Drita Siliqi, në mbiemër vajzërie Shundi, më 14 tetor 2005.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga z. A. Tartari, një avokat i cili e ushtron veprimtarinë në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj i asaj kohe z. S. Mëneri, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Më 6 dhjetor 2007, ankimet iu komunikuan Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHITJES

4. Ankuesit kanë lindur respektivisht në vitin 1937, 1933, 1941 dhe 1934 dhe jetojnë në Shqipëri dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

5. Më 30 dhjetor 1994, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave Tiranë (Komisioni), midis të tjerave, i njohu ankuesve të drejtat mbi pronën e trashëguar për një ngastër toke me përmasat 2,461.97 m² dhe vendosi që ta rikthente pronën. Përderisa ndërtesat ishin ndërtuar mbi këtë tokë nga një palë e tretë, Komisioni vendosi se pala e tretë duhet të paguajë qira për tokën ose ta riblejë atë, bazuar në një marrëveshje që do të vendoset midis palëve. Gjithashtu, ai pranoi të drejtën e ankuesve për t'i refuzuar fillimisht ndërtesat.

6. Më 18 shkurt 1997, ankuesit paraqitën një kërkesë civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë, në të cilën kërkonin anulimin e kontratës së shitjes së vitit 1996, të vendosur midis shtetit dhe palës së tretë, mbi dy ngastra toke me përmasat 197 m² dhe 195 m², të cilat ata pretendonin se iu përkisnin atyre. Gjithashtu, ankuesit kërkuan që pala e tretë të bënte pagesën e qirasë në mbështetje të aktit mbi pronën, i vitit 1993. Në po të njëjtën linjë procedimesh, pala e tretë paraqiti një kundërpërgjigje duke kërkuar anulimin e pjesshëm të vendimit të Komisionit.

7. Më 24 prill 2002, Gjykata e Lartë dha vendimin final në të cilin hidhte poshtë kërkesat e ankuesve. Ajo, gjithashtu, refuzoi edhe të drejtën e tyre për refuzimin e parë në lidhje me ndërtesat në ngastrat e tokës, të cilat ishin dhënë nga Komisioni. Ajo vendosi se ankuesve iu jepet e drejta për kompensim mbi ngastrën e tokës me përmasë 2,461/97 m², kompensim i cili do të përcaktohej në përputhje me aktin mbi pronën i vitit 1993.

8. Më 22 tetor 2004, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur si një bankë e plotë, nuk konstatoi shkelje të të drejtave të ankuesve për një gjykim të drejtë.

9. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

10. Ligji dhe praktika përkatëse vendase është përshkruar në detaje, *inter alia*, në vendimin “Manushaqe Puto dhe të Tjerët kundër Shqipërisë” (nr. 604/07, 43628/07 dhe 34770/09, §§ 23-53, 31



korrik 2012) dhe Ramadhi kundër Shqipërisë (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007).

11. Më 6 mars 2013 dhe 30 korrik 2014, Qeveria miratoi dhe lëshoi harta të reja për vlerësimin e pronës, të cilat përfshinin çmimin referencë për metër katrorë anëmbanë vendit (vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 187 më 6 mars 2013 dhe 514 më 30 korrik 2014).

III. MATERIAL I KËSHILLIT TË EVROPËS

12. Në vijim të ngjarjeve të përshkruara në vendimin “Karagjozi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë” [Këshilli], nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08 dhe 15075/09, §§ 36-38, 8 prill 2014, Komiteti i Ministrave nxori një vendim, më 6 mars 2014, mbi ekzekutimin e gjykimit të dhënë për moszbatim të vendimeve vendase juridike dhe administrative të formës së prerë nga ana e autoriteteve shqiptare, të cilat iu akordonin ankuesve kompensim në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, në vend të rikthimit fizik të ngastrave të tyre të tokës, i cili u miratua në takimin e 1193-të të tij, duke parashtruar si më poshtë vijon, për sa ka të bëjë me çështjen:

“Deputetët

(...)

2. i konsideruan aktet e ndërmarra që prej shtatorit 2013 dhe masat e parashikuara për javët dhe muajt në vijim si inkurajuese: megjithatë, duke ndjerë keqardhje se afati i përcaktuar nga vendimi pilot nuk u respektua, duke nënvizuar se në mënyrë që të përmbusheshin detyrimet e parashtruara nga Gjykata Evropiane dhe të realizohej mekanizmi i kërkuar për kompensim pa vonesa të mëtejshme dhe brenda kuadrit të propozuar nga plani i veprimit, angazhimi politik i shprehur në planin e veprimit duhet të ndiqet nga akte konkrete dhe thelbësore në nivel kombëtar, veçanërisht në fushat e identifikuar nga Komiteti në Rezolutën e tij të Përkohshme KM/ResDH(2013) 115:

(...).”

13. Vendimi i Komitetit të Ministrave, i datës 5 qershor 2014, mbi ekzekutimin e gjykimeve në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase juridike dhe administrative të formës së prerë nga ana e autoriteteve shqiptare, të cilat u akordojnë ankuesve kompensim në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, në vend të rikthimit fizik të ngastrave të tyre të tokës, i cili u miratua në takimin e tij të 1201, parashtrroi si më poshtë vijon, për sa

ka të bëjë me çështjen:

“Deputetët:

1. mirëpritën miratimin formal nga ana e Këshillit Shqiptar të Ministrave të planit të veprimit për ngritjen e një mekanizmi të efektshëm për kompensim, duke e bërë kështu të detyrueshëm planin e veprimit, dhe u shprehën të kënaqur se masat e parashikuara janë adaptuar në përputhje me parashikimet në këtë plan;

2. duke pasur parasysh afatin e përgjithshëm për implementimin e këtij mekanizmi, inkurajojnë fort autoritetet të intensifikojnë përpjekjet e tyre në mënyrë që të pakësojnë këtë kornizë kohore sa më shumë të jetë e mundur;

(...).”

LIGJI

I. BASHKIMI I ANKESAVE

14. Duke qenë se të dy ankesat përmbajnë të njëjtat fakte dhe pakënaqësi, Gjykata vendos se ato duhet të bashkohen në përputhje rregullin 42 § 1 i Rregullave të Gjykatës.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENEVE 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS SI EDHE E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

15. Nga mocioni i saj, Gjykata ngriti pyetjen nëse kishte pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me mospagimin të kompensimit për ankuesit nga ana e autoriteteve, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, i datës 24 prill 2002.

Neni 6 § 1 i Konventës, për sa ka lidhje me çështjen, përcakton si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdonjëri ka të drejtën për një seancë ... të drejtë ... dëgjimore nga [një] ... gjykatë ...”

Neni 13 i Konventës përcakton si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1, i Konventës përcakton si më poshtë:

“Çdo individ ka të drejtën të gëzojë i qetë pronat e tij. Asnjë nuk privohet nga pronat e tij, përveç kur preket interesi publik dhe kur bëhet subjekt i kushteve të parashikuara me ligj dhe



bazuar në parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Parashikimet e mëparshme nuk ndërhyjnë në të drejtën e një shteti për t'i zbatuar këto ligje, nëse shikohet si e arsyeshme të kontrollohet përdorimi i pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e taksave, të kontributeve ose penalteteve të tjera.”

A. PRANUESHMËRIA

16. Gjykata vëren se kjo pjesë e ankimeve nuk gjendet e pabazuar në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej ajo vëren se kjo pjesë nuk është e papranueshme në ndonjë aspekt tjetër. Për këtë arsye ajo duhet deklaruar e pranueshme.

B. CILËSITË

17. Qeveria parashtrroi se ankuesit nuk kërkuan kurrë kompensimin e akorduar nga vendimi i Gjykatës së Lartë, më 24 prill 2002. Ata këmbëngulën që prona t'u kthehej fizikisht. Autoritetet nuk mund të bëheshin përgjegjës për moszbatimin e vendimit, nga ankuesit nuk u ndërmon asnjë hap për zbatimin e tij.

18. Gjykata tashmë ka shqyrtuar dhe në vijim ka hedhur poshtë argumentin e Qeverisë në çështjen “Beshiri dhe të Tjerët kundër Shqipërisë”, nr. 7352/03, §§ 62-66, 22 gusht 2006. Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të arritur në një përfundim tjetër në këtë çështje.

19. Gjykata konstaton se moszbatimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës për kaq shumë vite nga ana e autoriteteve vendase, dhe siç duket mospagimi i kompensimit të akorduar, shkelte të drejtat e ankuesve referuar nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (shiko “Driza kundër Shqipërisë”, nr. 33771/02, GJEDNJ 2007-V (ekstrakte), “Vrioni dhe të Tjerët kundër Shqipërisë dhe Italisë”, nr. 35720/04 dhe 42832/06, 29 shtator 2009, “Manushaqe Puto dhe të Tjerët kundër Shqipërisë”, cituar më sipër).

20. Gjykata, gjithashtu, arrin në përfundimin se nuk ka pasur asnjë formë shpaguese vendase, e cila do të mund të kompensonte në mënyrën e duhur dhe mjaftueshëm për kohën e gjatë të moszbatimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës, i cili akordonte kompensim. Prandaj konstatohet një shkelje e nenit 13 të Konventës (shiko “Manushaqe Puto dhe të Tjerët kundër Shqipërisë”, cituar më sipër).

III. SHKELJE TË TJERA TË PRETE-NDUARA TË KUSHTETUTËS

21. Gjithashtu, ankuesit shprehën pakënaqësinë e bazuar në nenin 6 § 1 në lidhje me padrejtësinë e procedimeve vendase, për sa i përket interpretimit të ligjit vendas dhe rezultatit të atyre procedimeve.

22. Nën dritën e hedhur nga të gjitha materialet në zotërimin e saj, dhe përderisa deri më tani çështjet për të cilat është bërë ankesa janë në kompetencën e saj, Gjykata mendon se kjo pjesë e ankimit nuk shpalos ndonjë formë të shkeljes së Konventës. Më tej, ajo vijon se është e papranueshme në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a), duke qenë se nuk është e bazuar në fakte dhe sipas nenit 35 § 4 të Konventës duhet kundërshtuar.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

23. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

24. Ankuesit iu referuan raportit të vlerësimit të ekspertit, i cili kërkonte 1,639,000 euro (EUR) për dëmin monetar, i cili shkonte deri në 1,480,000 euro për sa i përket vlerës së ngastrës së tokës me përmasa 2,467/97 m² dhe 159,000 euro në lidhje me humbjen e përfitimeve. Ata, gjithashtu, kërkuan 200,000 euro për dëmin jomonetar.

25. Qeveria nuk dorëzoi një raport nga eksperti për shkak të kompleksitetit të kërkesave të ankuesve dhe mungesës së kohës. Megjithatë, ata rezervuan të drejtën për të vepruar kështu në një fazë më të vonë. Deri më sot, asnjë raport i tillë nuk është dorëzuar në Gjykatë.

26. Sipas natyrës jo të efektshme të sistemit aktual të kompensimit, dhe në veçanti duke pasur parasysh faktin se tashmë kanë kaluar 13 vjet që nga koha kur ankuesve iu akordua prona, Gjykata, pa gjykuar paraprakisht zhvillime të mundshme në të ardhmen, në lidhje me përcaktimin e një mekanizmi kompensimi efektiv e gjykon të arsyeshme t'u akordojë ankuesve një shumë e cila do të ishte zgjidhja përfundimtare dhe shteruese e çështjeve.

27. Gjykata sjell ndërmend konkluzionet e saj në çështjen “Vrioni dhe të Tjerët kundër Shqipërisë” (shlyerje e drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§



33-39, 7 dhjetor 2010, për sa i përket metodës së përlllogaritjes së dëmit monetar. Për këtë arsye, Gjykata do ta bazojë llogaritjen e dëmit monetar bazuar mbi hartat e vlerësimit të pronës miratuar nga Qeveria në vitin 2008 (shiko gjithashtu “Manushaqe Puto dhe të Tjerët”, cituar më sipër, § 125), ndërkohë që Qeveria nuk është mbështetur në hartat aktuale të vlerësimit të pronës.

28. Duke marrë parasysh materialet e paraqitura nga palët, si edhe në materialet që zotëron vetë, Gjykata e mendon si të arsyeshme që t’u akordojë ankuesve 1,498,400 euro për dëmin monetar dhe atë jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

29. Ankuesit kërkuar 10,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në Gjykatë. Ata nuk paraqitën një material të detajuar për të mbështetur kërkesën e tyre për kostot dhe shpenzimet.

30. Sipas rregullores së Gjykatës të përcaktuar nga praktika e mëparshme, një ankues ka të drejtën për t’u rimbursuar për kostot dhe shpenzimet vetëm nëse është provuar se faktikisht ato janë bërë nisur nga nevoja, dhe janë të arsyeshme (shiko Gjyli kundër Shqipërisë, nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Në këtë pikë, rregulli 60 §§ 2 dhe 3 i Rregullave të Gjykatës parashikon se ankuesit duhet t’i bashkëlidhin kërkesat e tyre për kompensim të drejtë, “çdo dokument mbështetës i lidhur me çështjen”, por nëse nuk e bën një gjë të tillë Gjykata “mund t’i refuzojë kërkesat plotësisht ose pjesërisht”.

31. Gjykata vëren se ankuesit nuk dorëzuan ndonjë dokument referues për të mbështetur kërkesat e tyre. Për këtë arsye, Gjykata nuk do të akordojë ndonjë shpërblim për kostot dhe shpenzimet.

C. Interes i vonuar

32. Gjykata e gjykon si të arsyeshme që norma e interesit të vonuar të bazohet në normën e huadhënies marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane, normë së cilës i duhen shtuar pikë 3-përqindëshe.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT:

1. Vendos të bashkojë ankesat nr. 37295/05 dhe 42228/05;

2. I deklaron ankesat në lidhje me nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si edhe nenin 1 të protokollit nr. 1 në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, të datës 24 prill 2002, të

pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshëm;

3. Vendos se ka pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;

4. Vendos:

a) Se shteti i paditur duhet t’u paguajë ankuesve, bashkërisht, brenda tre muajve, 1,498,400 euro (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind euro), plus taksat që mund të jenë të tarifueshme, për dëmin monetar dhe jomonetar ndaj të gjithë ankuesve për të dy ankimet, duke e konvertuar shumën në vlerën monetare të shtetit të paditur në normën që përdoret në ditën e shlyerjes;

b) se që nga mbarimi i periudhës së mësipërme prej tre muajsh deri në momentin e shlyerjes, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm në shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus pikë 3%;

5. Nuk pranon pjesën tjetër të kërkesës së ankuesve për shpërblim të drejtë.

E hartuar në anglisht dhe e mbajtur me shkrim më 10 mars 2015 në zbatim të rregullit 77 §§ 3 të Rregullave të Gjykatës.

Fatoş AracI

Zëvendëssekretar

George Nicolaou

President

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Seksioni i katërt

ÇËSHITJA “METALLA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

(Kërkesat nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08)

VENDIM

Strasburg

16 korrik 2015

Ky është vendim përfundimtar, por mund t’i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen “Metalla dhe të tjerë kundër Shqipërisë”,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si komitet (trup gjykues), i përbërë nga:

Fatoş AracI

Zëvendëssekretar

George Nicolaou

President



Pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 23 qershor 2015,

pas shënimit që çështja ligjore në themel të kërkesave më poshtë është tashmë objekt i praktikës ekzistuese gjyqësore të Gjykatës (*shihni “Manushaqe Puto dhe të Tjerët kundër Shqipërisë”*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, § 31 korrik 2012),

jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e treguar më sipër:

PROCEDURA

1. Çështja filloi nga katër kërkesa (nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga nëntë shtetas shqiptarë ndërmjet 13 qershorit 2008 dhe 8 tetorit 2008. Detajet e kërkesave dhe përfaqësuesve janë paraqitur në shtojcën nr. 1 bashkëngjitur vendimit.

2. Qeveria e Shqipëria (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj të asaj kohe, znj. S. Mëneri e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe znj. E. Hajro e Zyrës së Avokatit të Shtetit dhe rrjedhimisht znj. L. Mandia e Zyrës së Avokatit të Shtetit.

3. Më 21 janar 2010, kërkesat iu komunikuan Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHITJES

A. Kërkesa nr. 30264/08: Metalla

4. Më 9 gusht 1995, Komisioni i Shijakut i njohu kërkuessve titullin e trashëguar për një parcelë toke me sipërfaqe 1020 m² nga e cila 747 m² të kthyer. Meqë pjesa e mbetur e sipërfaqes së tokës, 272 m² ishte e zënë, kërkuessit do të kompensoheshin sipas njëres nga mënyrat e parashikuara me ligj.

5. Vendimi i Komisionit nuk u ekzekutua.

B. Kërkesa nr. 42120/08: Bushati

6. Më 8 shkurt 1995, Komisioni i Shijakut i njohu kërkuessit dhe trashëgimtarëve të tjerë titullin për një ndërtesë dykatëshe dhe një parcelë toke që rrethon ndërtesën me sipërfaqe 500 m². Meqë parcela e tokës me sipërfaqe 500 m² ishte e zënë, kërkuessi dhe trashëgimtarët do të kompensoheshin sipas njëres nga mënyrat e parashikuara me ligj. Gjithashtu u vendos që atyre t'u kthehet shtëpia.

7. Kërkuessi pretendon që në vitin 1995 dhe 1997 filloi procesin ligjor kundër një pale të tretë për lirim dhe kthimin e pronës së tij. Megjithatë,

ai vendosi të ndërpresë veprimet, duke pasur parasysh proceset gjyqësore të mbetura pezull në qytete të tjera. Pretendohet që pala e tretë ka ndërtuar pa leje në tokën e kërkuessit.

8. Vendimi i Komisionit nuk u ekzekutua.

C. Kërkesa nr. 54403/08: Metalla dhe të Tjerë

9. Më 9 gusht 1995, Komisioni i Shijakut i njohu kërkuessve titullin e trashëguar për një parcelë toke me sipërfaqe 5.527 m² nga e cila 5.000 m² të kthyer. Meqë pjesa e mbetur e sipërfaqes së tokës, 527 m² ishte e zënë, kërkuessit do të kompensoheshin sipas njëres nga mënyrat e parashikuara me ligj.

10. Vendimi i Komisionit nuk u ekzekutua.

D. Kërkesa nr. 54411/08: Metalla dhe të Tjerë

11. Më 13 gusht 2007, Komisioni i Durrësit i njohu kërkuessve titullin e trashëguar për një parcelë toke me sipërfaqe 65.000 m² nga e cila 60.000 m² të kthyer. Meqë pjesa e mbetur e sipërfaqes prej 5,000 m² ishte tokë bujqësore, rrugë dhe kanale (e llojit arë, rrugë dhe kanale) të zëna, kërkuessit do të kompensoheshin sipas njëres nga mënyrat e parashikuara me ligj.

12. Vendimi i Komisionit nuk u ekzekutua.

II. PRAKTIKA DHE LEGJISLACIONI PËRKATËS I BRENDSHËM

13. Praktika dhe legjislacioni përkatës i brendshëm janë përshkruar me hollësi, *inter alia*, në çështjen “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §§ 23-53, 31 korrik 2012) dhe “Ramadhi kundër Shqipërisë” (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007).

14. Më 6 mars 2013 dhe 30 korrik 2014, Qeveria miratoi dhe nxori hartat e reja të vlerësimit të pronës, që përfshijnë çmimin referencë për metër katror në mbarë vendin (vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 187 të 6 marsit 2013 dhe 514 të 30 korrikut 2014).

III. MATERIAL I KËSHILLIT TË EVROPËS

15. Në vijimësi të ngjarjeve të përshkruara në “Karagjozi dhe të Tjerë kundër Shqipërisë” [Komiteti], nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08 dhe 15075/09, §§ 36-38, 8 prill 2014, Komiteti i Ministrave më 6 mars 2014 mori një vendim për ekzekutimin e vendimeve në lidhje me mosekzekutimin nga autoritetet shqiptare



të vendimeve të brendshme gjyqësore dhe administrative të formës së prerë, që parashikonin kompensim sipas njërës nga mënyra e parashikuara me ligj për kërkuesit në vend të kthimit fizik të parcelave të tokave të tyre. Vendimi, i cili u miratua në takimin e 1193-të në lidhje me këtë, lexon si më poshtë:

“Zëvendësit

(...)

2. morën parasysh veprimet e ndërmarra që në shtator 2013 dhe masat nxitëse të parashikuara në javët dhe muajt e ardhshëm; megjithatë, me keqardhje që afati i caktuar në vendimin pilot nuk do të plotësohet, ata theksuan që për të përmbushur detyrimet e vëna nga Gjykata Evropiane dhe për të prezantuar mekanizmin e kërkuar të kompensimit pa vonesë dhe brenda afatit kohor të propozuar në plan veprim, angazhimi politik i shprehur në plan veprim duhet të ndiqet nga masa konkrete dhe thelbësore në nivel vendor, sidomos në fushat e identifikuara nga Komiteti në Rezolutën e tij të Ndërmjetme CM/ResDH(2013)115;

(...)”

16. Vendimi i Komitetit të Ministrave i 5 qershorit 2014 për ekzekutimin e vendimeve në lidhje me mosekzekutimin nga autoritetet shqiptare të vendimeve të brendshme gjyqësore dhe administrative të formës së prerë që parashikonin kompensim sipas njërës nga mënyra e parashikuara me ligj për kërkuesit në vend të kthimit fizik të parcelave të tokave të tyre, i cili u miratua në takimin e tij të 1201-të, në lidhje me këtë, lexon si më poshtë:

“Zëvendësit

1. përshëndesin miratimin formal nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë të planit të veprimit për krijimin e një mekanizmi kompensimi efektiv, duke e bërë në këtë mënyrë planin e veprimit të detyrueshëm dhe vërejnë me kënaqësi që masat e parashikuara po merren në përputhje me parashikimet e atij plani;

2. nisur nga afati i përgjithshëm i parashikuar për zbatimin e këtij mekanizmi, ato inkurajojnë fuqishëm autoritetet që të intensifikojnë përpjekjet e tyre me qëllim shkurtimin e afatit kohor sa më shumë që të jetë e mundur;

(...)”

17. Vendimi i Komitetit të Ministrave i 11 qershorit 2015, i cili u miratua në takimin e 1230-të

në lidhje me këtë lexon si më poshtë:

“Zëvendësit

1. mirëpresin angazhimin e treguar nga autoritetet shqiptare në kërkim të një zgjidhjeje të efektshme dhe të qëndrueshme për problemin e rëndësishëm strukturor në diskutim në këtë grup çështjes; përshëndesin në këtë drejtim prezantimin prej tyre të projekt ligjit dhe bashkëpunimin e tyre me Këshillin e Evropës, si edhe konsultimet e ngushta të zhvilluara me Departamentin e Ekzekutimit, sidomos në Tiranë më 23 prill 2015;

2. vërejnë që, siç kërkohet nga Komiteti i Ministrave dhe nga vendimi pilot Manushaqe Puto, autoritetet kanë bërë një rishikim të kujdesshëm të të gjitha implikimeve ligjore dhe financiare dhe kanë vlerësuar koston e përgjithshme të kompensimit për të pasur bazë konkrete për të marrë parasysh ndryshimet e nevojshme të legjislacionit;

3. ftojnë autoritetet shqiptare që të paraqesin, sa më shpejt që të jetë e mundur, shpjegimet dhe informacionin shtesë për zgjidhjet e propozuara në projekt ligj....

(...)”

LEGJISLACIONI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

18. Meqë të katër kërkesat parashtrajnë të njëjtën çështje, Gjykata vendos që ato duhet të bashkohen sipas rregullit 42 § 1 të Rregullores së Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA E ANKESAVE

A. Në lidhje me të gjitha kërkesat

19. Kërkuesit pretenduan shkelje të nenit 6 § 1 dhe 13 të Konventës, si edhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të brendshme të formës së prerë që njohin kompensim në vend të kthimit të pronave të tyre. Në lidhje me kërkesën nr. 42120/08, Gjykata me iniciativë të vet ngre pyetjen nëse është shkelur neni 6 § 1 dhe 13 i Konventës.

Neni 6 § 1 i Konventës, aq sa është relevant, lexon si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të degjohet.....nga [një] gjykatënë lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile....”

Neni 13 i Konventës lexon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që



veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Neni 1 i protokollit 1 të Konventës lexon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”.

20. Qeveria pretendon që kërkuessit nuk kanë përdorur zgjidhjet që janë prezantuar në periudhën 2005 dhe 2011.

21. Kërkuessit pretendojnë që zgjidhjet nuk kanë qenë të efektshme.

22. Gjykata konsideron që pyetja e ekzistencës së zgjidhjeve të efektshme në lidhje me mosekzekutimin e vendimit administrativ të formës së prerë dhe sidomos të zgjidhjeve të parashikuara me ligjin e pronave 2004 duhet të bashkohet me themelin dhe të shqyrtohet në lidhje me ankesën e kërkuessve sipas nenit 13. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që meqë ankesa e kërkuessve sipas nenit 6 § 1 të Konventës është “e diskutueshme”, neni 13 është i zbatueshëm (shihni mes të tjerash, “Eltari kundër Shqipërisë”, nr. 16530/06, § 80, 8 mars 2011).

23. Gjykata konsideron që këto kërkesa janë dukshëm të pabazuara sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Ankesat duke mos qenë të papranueshme për shkaqe të tjera duhet të shpallen të pranueshme.

B. Në lidhje me kërkesën nr. 42120/08:

24. Kërkuessi në kërkesën nr. 42120/08 pretendon që është shkelur neni 1 i protokollit nr. 1, sepse ka qenë e pamundur që ai të marrë në posedim shtëpinë dykatëshe dhe tokën që e rrethon me sipërfaqe 500 m².

25. Qeveria shprehet që kërkuessi nuk ka nisur proces ligjor kundër zaptuesit aktual të pronës.

26. Gjykata vëren që sipas nenit 35 § 1 të Konventës, ajo mund të shqyrtojë një ankesë “pas shterimit të të gjitha mjeteve të brendshme”. Në këtë drejtim, ajo vëren që ky kërkuess ka filluar, por

ka ndërprerë procesin ligjor për lirimin dhe kthimin e pronës së tij. Gjykata konkludon që kjo ankesë duhet të shpallet e papranueshme për moshterimin e mjeteve të brendshme dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 § 1 dhe 4 të Konventës.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS

27. Gjykata vëren që pyetja e ekzistencës së mjeteve efektive është shqyrtuar me hollësi në kërkesën e kërkuessve sipas nenit 13 në vendimin pilot “Manushaqe Puto dhe të Tjerë” (paragrafët 72-84). Në paragrafin 84 të vendimit pilot, Gjykata konstaton “që nuk ka mjet efektiv të brendshëm të lejuar për zgjidhjen e duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me mosekzekutimin e tejzgjatur të vendimeve të Komisionit në lidhje me kompensimin”. Nuk ka arsye për t’u shmangur këtyre gjetjeve.

28. Prandaj konstatohet shkelje e nenit 13 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë që kërkuessi nuk ka shteruar zgjidhjet e brendshme efektive.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1

29. Kërkuessit ankohen që mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë në favor të tyre, të ndryshuara sipas rastit, është shkelje e të drejtave të tyre sipas nenit 6 § 1 dhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

30. Qeveria ka ngritur të njëjtat argumente, të shqyrtuara dhe të hedhura poshtë në vendimin pilot “Manushaqe Puto dhe të Tjerë” (cituar më sipër, §§ 87-97). Gjykata nuk sheh arsye për të arritur në një konkluzion të ndryshëm në këto çështje.

31. Gjykata konstaton që mosekzekutimi nga autoritetet vendore gjatë kaq shumë viteve i vendimeve të brendshme dhe sidomos mospagimi i kompensimit janë shkelje e të drejtave të kërkuessve sipas nenit 6 § 1 dhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

32. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme,



Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

1. Dëmi

a) Parashtrimet e palëve

33. Kërkuesit, me përjashtim të kërkuesit në kërkesën nr. 42120/08, u bazuan në raportet e vlerësimit të ekspertëve dhe bënë kërkesat e mëposhtme në lidhje me dëmin monetar dhe jomonetar.

Emri dhe numri i kërkesës	Dëmi monetar	Dëmi jomonetar
Metalla nr. 30264/08	24,908 euro në lidhje me vlerën e pronës për sipërfaqen e tokës prej 272 m ² në bazë të çmimeve të tregut në vitin 2010; ose 14,280 euro në lidhje me vlerën e pronës për sipërfaqen e tokës prej 272 m ² në bazë të çmimeve të vitit 1995 së bashku me humbjen e fitimit.	70,000 euro në lidhje me të tre kërkesat.
Metalla dhe të Tjerë nr. 54403/08	38,095 euro në lidhje me vlerën e pronës për sipërfaqen e tokës prej 527 m ² në bazë të çmimeve të tregut në vitin 2010; ose 21,923 euro në lidhje me vlerën e pronës për sipërfaqen e tokës prej 527 m ² në bazë të çmimeve të vitit 1994 së bashku me humbjen e fitimit.	
Metalla dhe të Tjerë nr. 54411/08	80,586 euro në lidhje me vlerën e pronës për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 5.000 m ² në bazë të çmimeve të tregut në vitin 2010; ose 104,000 euro në lidhje me vlerën e pronës për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 5.000 m ² në bazë të çmimeve të vitit 2007 së bashku me humbjen e fitimit.	
Bushati, nr. 42120/08	823,000 lekë (5,772 euro) në lidhje me vlerën e sipërfaqes së tokës prej 500 m ² në bazë të VKM 139/2008 sipas të cilit çmimi i referencës në Dajç, Shijak është 1,646 lekë, pa asnjë pretendim specifik në lidhje me pjesën e pasurisë të kërkuesit; 2,500,000 lekë (17,534 euro) për vlerën e shtëpisë; 900,000 lekë (6,312 euro) për humbjen e fitimit.	Asnjë (nuk u bë asnjë kërkesë).

34. Qeveria parashtron që hartat e vlerës japin çmimet e mëposhtme: 12,200 lekë në lidhje me kërkesat nr. 30264/08 dhe 54403/08, bazuar në VKM-në nr. 1620 të 26 nëntorit 2008; 632 lekë në lidhje me kërkesën nr. 54411/08, bazuar në VKM-në nr. 139 të 13 shkurtit 2008 dhe 1,317 lekë në lidhje me kërkesën nr. 42120/08, bazuar në VKM-në nr. 139 të 13 shkurtit 2008.

35. Në përfundim, Qeveria ftoi Gjykatën që të zbatojë kompensimin financiar sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

b) Vlerësimi i Gjykatës

36. Nisur nga natyra joefektive e sistemit aktual të kompensimit dhe duke pasur parasysh, sidomos, faktin që kanë kaluar shumë vite që kur kërkuesve u është njohur kompensimi, Gjykata, pa paragjykuar zhvillime të mundshme në të ardhmen në lidhje me krijimin e një mekanizmi efektiv kompensimi, e konsideron të arsyeshme që t'i japë kërkuesit një

shumë që do të ishte zgjidhje përfundimtare dhe shteruese e çështjeve përpara gjykatës.

37. Gjykata sjell në vëmendjen gjetjet e saj në çështjen “Vrioni dhe të Tjerë kundër Shqipërisë” (kompensim i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§ 33-39, 7 dhjetor 2010 në lidhje me metodën e llogaritjes së dëmit monetar. Gjykata do të bazojë llogaritjen e saj për dëmin monetar në hartat e vlerës së pronave të miratuara nga Qeveria në vitin 2008 (shihni gjithashtu, “Manushaqe Puto dhe të Tjerë”, të përmendura më sipër, § 125), duke mos u mbështetur nga harta më e fundit e Qeverisë për vlerën e pronës.

38. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve dhe material në dispozicion, Gjykata konsideron të arsyeshme që të jepet dëmshpërblim monetar dhe jo monetar sipas paraqitjes në formë tabulare në shtojcën nr. 2.



2. Kosto dhe shpenzime
a) Parashtrimet e palëve

39. Kërkuesit ngritën pretendimet e mëposhtme në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

Emri dhe numri i kërkesës	Procesi gjyqësor i brendshëm	Procesi gjyqësor në Strasburg
Metalla, nr. 30264/08	8,935 euro në lidhje me të tre kërkesat (Faturat janë paraqitur.)	
Metalla dhe të Tjerë nr. 54403/08		
Metalla dhe të Tjerë nr. 54411/08		
Bushati, nr. 42120/08	Asnjë (Nuk u bë asnjë kërkesë.)	150,000 lekë (1,050 euro) (Nuk janë paraqitur faturat.)

40. Qeveria kundërshton që faturat në kërkesat nr. 30264/08, 54403/08 dhe 54411/08 nuk janë fatura zyrtare në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Qeveria gjithashtu kundërshtoi pretendimet e kërkuesve për kostot dhe shpenzimet si të tepruara dhe të paarsyeshme.

b) Vlerësimi i Gjykatës

41. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, kërkuesi ka të drejtë rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve nëse provohet që këto kosto dhe shpenzime janë kryer dhe kanë qenë të domosdoshme dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës (shihni “Gjyli kundër Shqipërisë”, nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Për këtë qëllim, rregulli 60 §§ 2 dhe 3 i rregullores së Gjykatës parashikon që kërkuesit, së bashku me pretendimet e tyre për kompensim të drejtë, duhet të përfshijnë “çdo dokument mbështetës”, pa të cilin Gjykata “mund të refuzojë pretendimet tërësisht ose pjesërisht”.

42. Gjykata nuk mund të pranojë sugjerimin e Qeverisë që kërkohen fatura të miratuara zyrtarisht nga autoritetet tatimore: ky nuk është detyrim sipas Konventës, sepse nuk i takon kësaj Gjykate që të rregullojë marrëdhënien ndërmjet një taksapaguesi dhe shtetit (shihni për shembull “Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë”, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, § 129, 1 prill 2014). Duke pasur parasysh praktikën e konsoliduar gjyqësore si rezultat i miratimit të vendimit pilot “Manushaqe Puto dhe të Tjerë”, natyrën përsëritëse e ankesave të ngritura në kërkesat e mësipërme, parashtrimet e njëjta të bëra në Gjykatë, përfaqësimin e kërkuesve nga i njëjti avokat dhe mendimin e Gjykatës së shumica e kostove dhe shpenzimeve të pretenduara nuk është e arsyeshme sa i përket shumës, Gjykata vendos që

të vendosë kompensimin prej 3000 euro në lidhje me të tri kërkesat nr. 30264/08, 54403/08 dhe 54411/08.

43. Gjykata më tej vëren që kërkuesi në kërkesën nr. 42120/08 nuk ka paraqitur asnjë dokument në mbështetje të pretendimit të tij siç kërkohet nga rregulli 60 i rregullores së Gjykatës. Prandaj, Gjykata nuk do të njohë kompensim në lidhje me kostot dhe shpenzimet në lidhje me atë çështje.

3. Interesi për mospagimin

44. Gjykata e konsideron të përshtatshme që norma e interesit për mospagimin duhet të bazohet në normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane, të cilës duhet t'i shtohen tre pikë përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET:

1. Vendos të bashkojë kërkesat;

2. Vendos t'i bashkojë themelit të ankesës sipas nenit 13 të Konventës kundërshtimin e Qeverisë në lidhje me ezaurimin e zgjidhjeve të brendshme;

3. Shpall të pranueshme ankesat e kërkuesve sipas nenit 13 dhe 6 § 1 të Konventës, si edhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për kompensimin e pronave në vend të kthimit fizik të tyre;

4. Shpall të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës nr. 42120/08.

5. Gjykon që është shkëlur neni 13 dhe 6 § 1 i Konventës, si edhe neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës dhe rrjedhimisht, rrezon kundërshtimin e Qeverisë për shterimin e zgjidhjeve të brendshme;

6. Gjykon:



a) që Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit të kërkesës nr. 42120/08, brenda tre muajve, shumën e caktuar në paragrafin 38 të vendimit dhe të paraqitur në tabelën e shtojcës 2, plus çdo takse që mund t'i ngarkohet kërkuesit, e cila duhet të konvertohet në monedhën kombëtare sipas normës së interesit të datës së shlyerjes;

b) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkuesve të kërkesave nr. 30264/08, 54403/08 dhe 54411/08, së bashku, brenda tre muajve, shumat e caktuara në paragrafin 38 dhe 42 të vendimit dhe të paraqitur në tabelën e shtojcës 2 plus çdo takse që mund t'i ngarkohet kërkuesit, e cila duhet të konvertohet në monedhën kombëtare sipas normës së interesit të datës së shlyerjes;

c) që nga mbarimi i afatit të sipërpërmendur tremujor deri në datën e shlyerjes, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

7. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 korrik 2015 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Fatoş AracI
Zëvendës Sekretar

George Nicolaou
President

SHTOJCA 1- LISTA E PJESËMARRËSVE

Nr.	Emri dhe nr. i çështjes	Emri i aplikantëve (viti i lindjes)	Vendi i qëndrimit	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes
1.	Metalla, nr. 30264/08	Nezmi Metalla (1943) Bujar Metalla (1956)	Shqipëri	E. Muharremaj, avokat	13 qershor 2008
2.	Bushati, nr. 42120/08	Genc Bushati (1944)	Shqipëri	B. Muslija, avokat	9 gusht 2008
3.	Metalla dhe të Tjerë nr. 54403/08	Nezmi Metalla (1943) Bujar Metalla (1956)	Shqipëri	E. Muharremaj, avokat	8 tetor 2008
4.	Metalla dhe të tjerë nr. 54411/08	Shyqyri Metalla (1947) Besnik Metalla (1961) Ferik Metalla (1969) Dhurata Metalla, mbiemri i vajzërisë Duka (1956) Sanije Sinjari (1928) Fiqirete Gashi (1931)			

SHTOJCA 2 – DËMI MONETAR DHE JO MONETAR SI EDHE KOSTOT DHE SHPENZIMET

Emri dhe nr. i kërkesës	Dëm monetar dhe jo monetar	Kosto dhe shpenzime
Metalla, nr. 30264/08	23, 200 euro (njëzet e tre mijë e dyqind euro)	3,000 euro (tre mijë euro)
Metalla dhe të Tjerë nr. 54403/08	97,000 euro (nëntëdhjetë e shtatë mijë euro)	
Metalla dhe të Tjerë nr. 54411/08		
Bushati, nr. 42120/08	1,500 euro (një mijë e pesëqind euro në lidhje me pjesën e kërkuesit)	Asnjë (Nuk është paraqitur asnjë faturë.)

**UDHËZIM**

Nr. 4381/1, datë 22.9.2015

**PËR TRANSFORMIMIN E
KOORDINATAVE NGA KORNIZA
REFERUESE GJEODEZIKE GLOBALE
“ETRF2005 (EPOKA 2007.2)” DHE SISTEMI
GJEODEZIK SHQIPTAR “ALB86” NË
KORNIZËN REFERUESE GJEODEZIKE
EVROPIANE “ETRF2000 (EPOKA
2014.177)” DHE “ETRF2000 (EPOKA 2008)”**

Bazuar në nenin 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.8.2013, me propozim të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike

UDHËZON:

1. Për transformimin e koordinatave nga korniza referuese gjeodezike globale “ETRF 2005

(Epoka 2007.2)” dhe Sistemi Gjeodezik Shqiptar “ALB86” në Kornizën Referuese Gjeodezike Evropiane “ETRF 2000 (Epoka 2014.177)” dhe “ETRF 2000” (Epoka 2008)” të përdoret udhëzuesi i propozuar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe që është pjesë e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), autoritete përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore, sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012 dhe çdo institucion tjetër që përdor informacion gjeohapësinor, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Milena Harito

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës”Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë